



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i procedurës paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratorja: Dr. Fidelma Donlon

Data: 24 shkurt 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Dejvid Huper

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të rregullës 9(5)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) nxjerr vendimin e mëposhtëm.

1. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesat për lirim të përkohshëm të secilit prej të akuzuarve në këtë çështje.² Të akuzuarit më pas apelian vendimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.³
2. Më 16 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Mbrojtjen e secilit prej të akuzuarve të paraqiste parashtrimet përkatëse nëse arsyet për vazhdimin e paraburgimit ishin ende të pranishme (“Parashtrimet mbi Paraburgimin”).⁴
3. Më 23 shkurt 2020, Mbrojtja e secilit prej të akuzuarve parashtrroi një kërkesë të përbashkët për zgjatjen e afatit për dorëzimin e Parashtrimeve mbi Paraburgimin, sipas rastit, deri në dhjetë ditë nga data e marrjes së vendimit të pritshëm të Panelit

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00177/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik; F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik; F00179/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Rexhep Selimit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik; F00180/RED, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Jakup Krasniqit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik.

³ KSC-BC-2020-06/IA001, F00001, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë e Mbrojtjes për Apelimin e “Vendimit mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm”*, 1 shkurt 2021, publike; KSC-BC-2020-06/IA002, F00001/RED, Mbrojtja e Jakup Krasniqit, *Version i Redaktuar Publik i Apelit të Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit mbi Kërkesën e Jakup Krasniqit për Lirim të Përkohshëm*, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, datë 3 shkurt 2021, 3 shkurt 2021, publik, me Shtojcën 1, publike; KSC-BC-2020-06/IA003, F00001/RED, Mbrojtja e z. Selimi, *Version i Redaktuar Publik i Apelit të Vendimit mbi Kërkesën e Rexhep Selimit për Lirim të Përkohshëm*, 3 shkurt 2021, publik; KSC-BC-2020-06/IA004, F00001/RED, Mbrojtja e Hashim Thaçit, *Version i Redaktuar Publik i Apelit të Mbrojtjes së Thaçit kundër “Vendimit mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm”*, 3 shkurt 2021, publik, me Shtojcat 1-2, publike.

⁴ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 16 shkurt 2021, f. 318, rreshtat 17-23.

të Gjykatës së Apelit mbi apelet e tyre (“Kërkesa për Zgjatjen e Afatit”).⁵ Mbrojtja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e kërkuar të afatit, pasi do të ishte më mirë që Parashtrimet mbi Paraburgimin të bëhen pas marrjes dhe shqyrtimit të vendimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelet përkatëse të të akuzuarve.⁶

4. Në bazë të rregullës 9(5)(a), nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores ose prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

5. Pas shqyrtimit të arsyeve që parashtron Mbrojtja e secilit prej të akuzuarve, veçanërisht faktit se Parashtrimet mbi Paraburgim do të përfitonin nga shqyrtimi i vendimeve të pritshme të Panelit të Gjykatës së Apelit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme që përlligjin zgjatjen e kërkuar të afatit. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vëren se të akuzuarit kanë hequr dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit para përfundimit të afatit dymujor të përcaktuar në Ligjin nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe në Rregullore.⁷

6. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

MIRATON Kërkesën për Zgjatjen e Afatit dhe në lidhje me Mbrojtjen e secilit prej të Akuzuarve **NDRYSHON** afatin për dorëzimin e parashtrimeve përkatëse nëse arsyet për vazhdimin e paraburgimit janë ende të pranishme, deri në **dhjetë ditë pas njoftimit të vendimit të pritshëm të Panelit të Gjykatës së Apelit** mbi apelet e të akuzuarve kundër vendimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për refuzimin

⁵ KSC-BC-2020-06, F00205, Mbrojtja e Hashim Thaçit, Mbrojtja e Kadri Veselit, Mbrojtja e Rexhep Selimit, Mbrojtja e Jakup Krasniqit, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit*, 23 shkurt 2021, publike.

⁶ Kërkesa për Zgjatjen e Afatit, para. 4, 6.

⁷ Kërkesa për Zgjatjen e Afatit, para. 5.

e lirim të përkohshëm. Përgjigjet dhe kundërpërgjigjet ndaj këtyre parashtrimeve do të bëhen në përputhje me afatet e përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

 /nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 24 shkurt 2021
Në Hagë, Holandë.